



**KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT**

V E N D I M

Nr. 34, datë 25.09.2024

PËR

MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN:

**“LALZI'S GARDEN”, RESORT ME HOTELERI, APARTAMENTE DHE SHËRBIME
TURISTIKE ME 1, 2, 3, 4, 5 DHE 6 KATE MBI TOKË DHE 1-2 KATE NËNTOKË, ME
TARRACA TË SHFRYTËZUESHME DHE ME MUR RRETHUES, ME VENDNDODHJE
NË BASHKINË DURRËS**

Në mbështetje të neneve 27, 28 Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr.519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit” e ndryshuar, me propozim të subjekti zhvillues shoqërisë “Insifa 6 vëllezërit” sh.p.k., Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:


1. Miratimin me kusht të Lejes së Ndërtimit për objektin: “Lalzi's Garden”, Resort me hoteleri, apartamente dhe shërbime turistike me 1, 2, 3, 4, 5 dhe 6 kate mbi tokë dhe 1-2 kate nëntokë, me tarraca të shfrytëzueshme dhe me mur rrethues”, me vendndodhje në Bashkinë Durrës, me subjekt zhvillues shoqërinë “Insifa 6 vëllezërit” sh.p.k.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave dhe Dokumenti i Rregullores së Veçantë i bashkëlidhet këtij vendimi si pjesë përbërëse e tij.
3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit kërkues vetëm pas:
 - a) plotësimit të dokumentacionit tekniko-ligjor;
 - b) pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Durrës.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit dhe Ministria e Turizmit dhe Mjedisit për zbatimin e këtij vendimi.
5. Vendimi, pasi nënshkruhet nga Kryetari, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit, hyn në fuqi menjëherë.



MINISTËR I LINJËS
MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT
MIRELA KUMBARO FURXHI



ANËTAR / SEKRETAR I KKT
DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT
ADELAJDA ROKA



Në shkruar më datë 11.07 2025